



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:249870

Datë: 19.01.2024

Numri i dokumentit: 05215830

C.nr.9245/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.A. “K. . . ”me seli në Prishtinë, ndaj të paditurit M. L. nga Fushë Kosova, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 195.99 euro, jashtë seancës, me datë 19.01.2024 mori këtë:

AKTGJYKIM

Për shkak të padëgjueshmërisë

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.A “K. . . “. , me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri M. L. nga Fushë Kosova, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguajë shumën prej 195.99 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar prej datës 09.12.2021 si datë e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

Arsyetimi

Paditësja, me datë 09.12.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurit, për kompensimin e dëmit material, me kamatë ligjore.

Në padi ka theksuar se sipas Aktgjykimit P.nr.2461/20, të datës 29.06.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili ka marrë formën e prerë me datë 02.09.2021, i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale “Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa tani paditësi për kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale është udhëzuar në kontest civil. Kështu, ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të aprohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

I padituri, me datë 29.03.2022 e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat, por fare nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 150 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se plotësohen të

gjitha kushtet për marrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë, andaj, pa caktuar seancë fare, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Neni 150.1 i LPK-së, parasheh se *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”*.

Sa i përket kushtit të parë të cekur më lart, gjykata nga shkresat e lëndës, konstaton se i padituri e ka pranuar me rregull edhe aktvendimin për përgjigje në padi, bashkë me padinë dhe provat tjera, dhe ka qenë i njoftuar me aktvendimin për përgjigje në padi, që nëse i padituri nuk përgjigjet në padi dhe gjykata vlerëson se plotësohen kushtet ligjore, do të marrë aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë, por, megjithatë, i padituri nuk është përgjigjur në padi.

Sa i përket gjendjes faktike, nga Aktgjykimi P.nr.2461/20, të datës 29.06.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili ka marrë formën e prerë me datë 02.09.2021, gjykata vërtetoi faktin se i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale “Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314, parag. 6, lidhur me parag. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me çka sipas aktgjykimit të lartcekur ishte vërtetuar se këtu i padituri, i kishte shkaktuar paditëses si e dëmtuar, dëm në vlerë prej 195.99 euro, ndërsa tani paditësja për kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale është udhëzuar në kontest civil.

Nga fatura me numër DPRHP2030019, e datës 07.08.2020, e lëshuar nga “K. . .”, gjykata vërtetoi faktin se sipas kalkulimit të cekur në këtë faturë, dëmi që ishte llogaritur se duhet të rikthehet nga i padituri në emër të rikthimit të humbjeve është në vlerë prej 195.99 euro.

Gjykata vlerësoi edhe provat tjera në shkresat e lëndës, por të njëjtat ishin të parëndësishme për të vendosur ndryshe.

Në rastin konkret lidhur me kushtin e dytë që ka të bëjë me themelësinë e kërkesëpadisë, gjykata lidhur me bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë u bazua në aktgjykimin e lartcekur me të cilin i padituri ishte shpallur fajtor, dhe faturën për llogaritjen e lartësisë së dëmit, ku sipas nenit 12 të LPK-së, parashihet se *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”*

Ndërsa detyrimi i të paditurit që paditësit t’ia paguajë dëmin e shkaktuar, e të vërtetuar më sipër, rrjedh nga neni 136, parag. 1, i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), sipas të cilit nen parashihet se *“1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* Me nenin 137 është paraparë se *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe*

shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).” Me nenin 169, paragraf. 1 dhe 3 të LMD-së është paraparë që “1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.”

Rrjedhimisht, nga gjendja faktike e lartcekur, e vërtetuar me provat e propozuara nga paditësja, gjykata konstaton se plotësohet edhe kushti i tretë për marrjen e këtij lloji të aktgjykimit, pasi që faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësja apo me faktet e ditura botërisht, por përkundrazi, janë në përputhje të plotë me provat e propozuara nga paditësja.

Lartësia e kamatës prej 8%, është përcaktuar në bazë të nenit 382 të LMD-së dhe e njëjta do të llogaritet në shumën e aprovuar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta të procedurës, pasi që pala që në këtë proces ka pasur sukses, pra pala paditëse, nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës, detyrim ky i paraparë me nenin 463, paragraf. 1 dhe 2, ku parashihet “1. Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. 2 Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.9245/21, datë 19.01.2024

Gjyqtari
Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, në bazë të nenit 491 të LPK-së, ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.